



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ENERGJISË  
DHE INDUSTRIË

URDHËR

Nr. 150, Datë 18 / 04 / 2017

PËR

**PROCEDURAT E PAGESAVE NDAJ SUBJEKTEVE TË CILËVE NUK U ËSHTË  
PËRMBUSHUR DETYRIMI I DHËNIES SË KOMPNESIMIT PËR DËMET NË  
KULTURAT BUJQËSORE DHE NË BIZNESE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Vendimit Nr. 842, datë 06.12.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e vlerës së kompensimit të dëmeve të shkaktuara në kulturat bujqësore e në biznese nga reshjet e shiut dhe përmytjet, në qarkun e Shkodrës”, i ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. KESH sh.a. mbi bazën e të dhënave të dërguara nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe OSHEE sh.a. në zbatim të Vendimeve Nr. 842, datë 06.12.2011, i ndryshuar, Nr. 482, datë 06.05.2015 të Këshillit të Ministrave, dhe VKM Nr. 295, datë 05.04.2017 të fillojë menjëherë rakordimin e detyrimeve që nuk janë përmbushur ndaj përfituesve.
2. KESH sh.a. shpall në faqen zyrtare web ([www.kesh.al](http://www.kesh.al)), listën e rakorduar të përfituesve me vlerën përkatëse të dëmshpërblimit për t'u paguar si dhe procedurat për vjeljen e dëmshpërblimit nga përfituesit.
3. KESH sh.a. nëpërmjet përdorimit të fondeve të veta ose nëpërmjet vjeljes së të drejtave të arkëtueshme (kredi) nga të tretët, të shlyejë për përfituesit vlerën e rakorduar të dëmshpërblimit në formën e çekut bankar.
4. Për shlyerjen e detyrimeve që nuk janë përmbushur ndaj përfituesve (siç janë rakorduar në pikën 1 më sipër), KESH sh.a. ngre grupe pune me stafin e vet për dorëzimin e çeqeve bankare.
5. Për lehtësimin dhe asistimin e grupeve të dorëzimit në procesin e evidentimit, kontaktimit dhe rakordimit të përfituesve në terren dhe dorëzimin e çeqeve bankare tek këta përfitues, KESH sh.a. të kontraktojë punonjës të përkohshëm si referente në secilën Njësi Administrative të zonës së prekur nga përmytjet.
6. Nëse raste të zëvendësimit, për shkak vdekje, të personit që tërheq dëmshpërblimin për dëmet e shkaktuara, KESH sh.a. të dorëzojë çekun bankar për vjeljen e dëmshpërblimit pranë kryefamiljarit.

7. Ngarkohet Administratori i KESH sh.a për zbatimin e këtij Urdhëri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**DAMIAN GJIKNURI**

A large, stylized handwritten signature in black ink, written over the official seal and the name of the minister.